



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

---

KOMISIONI PËR ÇËSHTJE NORMATIVE

**RAPORTI GJASHTMUJOR I PUNËS  
SË KOMISIONIT PËR ÇËSHTJE NORMATIVE PËR  
VITIN 2023**

Shtator, 2023.

## **A. Tabela e përmbajtjes**

1. Tabela e përmbajtjes.....	2
2. Përmbledhje ekskluzive.....	3
3. Rregulloret e miratuara në Këshill .....	5
4. Udhëzimi administrativ dhe udhëzuesit e miratuar në Këshill .....	5
5. Kodi i Etikës dhe doracaku i miratuar në Këshill.....	6
6. Katalogët e pozitive dhe përshkrimit të vendeve të punës për të punësuarit në Këshill .....	7
8. Përfundim .....	8

## **PËRMBLEDHJE EKSKLUZIVE:**

Komisioni për Çështje Normative (tutje: KÇN), është Komisioni i përhershëm i Këshillit, sipas nenit 16 par. pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

Me vendimin e Këshillit të datës 28 korrik 2021, KÇN, ka këtë përbërje:

1. Drita Rexhaj – Kryetare e KÇN-së,
2. Qerim Ademaj – anëtar i KÇN-së,
3. Fidan Hoxha –anëtar i KÇN-së,
4. Teuta Ibrahimimi – anëtare rezervë e KÇN-së.

KÇN, në pajtim me nenin 19 par. 2 të Rregullores 03/2020 mbi Organizimin dhe veprimtarin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, raporton në Këshill së paku një (1) herë në vit.

Mbi këtë bazë ligjore KÇN, ka përgatitur Raportin vjetor si në vijim:

Bazuar në Planin e Punës dhe vendimeve që kanë dal nga takimet e Këshillit dhe legjislacionit në fuqi, KÇN është angazhuar maksimalisht gjatë periudhës Janar – Qershor të vitit 2023 për përgatitjen, hartimin, shqyrtimin dhe finalizimin e akteve normative, ka mbajtur dyzet e pesë (45) takime, shtatë (7) takime si grup punues dhe shtatë (7) punëtori, prej të cilave një (1) ka qenë një ditore, ndërsa gjashtë (6) punëtori kanë qenë tre (3) ditore, në të cilat kanë marrë pjesë partnerë vendor dhe ndërkombëtarë.

Komisioni për Çështje Normative, në pajtim me Planin e punës së Këshillit për vitin 2023 dhe objektivat strategjike të mbështetura në Strategjinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës ka hartuar dhe miratuar planin e punës së tij. KÇN në plan të punës së tij ka paraparë gjithsejtë njëzet e katër (24) akte normative për hartim, shqyrtim dhe rekomandim, prej të cilave trembëdhjetë (13) rregullore, katër (4) rregullore për ndryshim dhe plotësim të rregullores bazë, një (1) udhëzim administrativ për ndryshim dhe plotësim të udhëzimit administrativ bazë, një (1) udhëzim administrativ, dy (2) katalogë të pozitave dhe përshkrimit të vendeve të punës për të punësuarit dhe një (1) kod të etikës për përkthyes dhe intepret gjyqësorë.

KÇN, gjatë këtij gjashtë mujori është angazhuar maksimalisht në përmbushjen e obligimeve të cilat i ka marrë përmes planit të punës së tij, vendimeve të Këshillit dhe kërkesave ligjore, ka

finalizuar dhe i ka rekomanduar për miratim gjithsej katërbëdhjetë (14) akte normative, prej të cilave njëmbëdhjetë (11) janë sipas planit të punës, ndërsa tre (3) prej tyre janë akte normative të finalizuara jashtë planit të punës. Aktet normative të rekomanduara në Këshill për miratim janë si në vijim:

- tetë (8) rregullore prej të cilave katër (4) rregullore janë për plotësimin dhe ndryshim e katër (4) rregulloreve bazë;
- dy (2) udhëzime administrative;
- një doracak; dhe ,
- një kod të etikës për përkthyes dhe interpret gjyqësorë.

Në kuadër të këtyre akteve KÇN, ka finalizuar edhe 16 shtojca. Të gjitha këto akte së bashku me shtojcat janë miratuar në Këshill.

## **RREGULLORET E MIRATUARA NË KËSHILL**

Rregulloret e shqyrtuara, të finalizuara dhe të rekomanduara për miratim, e të cilat janë miratuara në Këshill për periudhën Janar- Qershor të vitit 2023 janë si në vijim:

1. Rregullore Nr.01/2023 për Procedurën e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Drejtorit të Njesisë për Inspektim Gjyqësor të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
2. Rregullore Nr.02/2023 për Qasje në Dokumente Publike;
3. Rregullore Nr.03/2023 për Normën e Punës së Gjyqtarëve;
4. Rregullore Nr.04/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.01/2014 për procedurën e ngritjes në detyrë të Gjyqtarëve;
5. Rregullore Nr.05/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.01/2021 për Vlersimin e performancës së Gjyqtareve;
6. Rregullore Nr.06/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr.04/2022 për Procedurën e Rekrutimit, Përzgjedhjen dhe Themelimin e Marrëdhënies së Punës për Administratorë të Gjykatave;
7. Rregullore Nr. 07/2023 për Procedurën e Certifikimit, Emërimit, Kushtet, të Drejtat, Detyrimet, Shpërblimin dhe Disiplinimin e Përkthyesve dhe Interpretëve Gjyqësorë;
8. Rregullore Nr. 08/2023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 11 /2022 për Evidencën Penale në Republikën e Kosovës;

## **UDHËZIMET ADMINISTRATIVE TË MIRATUARA NË KËSHILL**

KÇN për periudhën raportuese Janar- Qershor të vitit 2023, përveç rregulloreve të listuara në këtë raport, ka hartuar, finalizuar dhe rekomanduar për miratim edhe dy (2) udhëzime administrative. Udhëzimet administrative të finalizuara janë miratuar në Këshill dhe janë si në vijim:

1. Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2023 për Procedurën për Kompensimin e Dëmit të Personave të Dënuar ose të Arrestuar pa Arsyë;
2. Udhëzimi Administrativ Nr. 02 /2023 për Kompensimin për Udhëtime Zyrtare dhe Shpenzime të Përfaqësimit në Sistemin Gjyqësor.
3. Udhëzimi Administrativ Nr. 03/2023 për Instalimin dhe Përdorimin e Kamerave të Sigurimit dhe Ruajtjen e Video Regjistrimeve në Gjykatat e Republikës së Kosovës

## **KODI I ETIKËS DHE DORACAKU I MIRATUAR NË KËSHILL**

KÇN, përveç finalizimit dhe rekomandimit të akteve normative të më sipërme ka hartuar, shqyrtuar, finalizuar dhe rekomanduar për miratim edhe një kod të etikës dhe një doracak, të cilat janë miratuar në Këshill. Kodi i etikës dhe doracaku të miratuar janë si në vijim:

1. Kodi i Etikës për Përkthyes dhe/apo Përkthyes dhe Interpret Gjyqësor të Certifikuar dhe Emëruar;
2. Doracaku për punën e përkthyesve dhe interpretëve në sistemin gjyqësor të Kosovës.

## **KATALOGËT I POZITAVE DHE PËRSHKRIMIT TË VENDEVE TË PUNËS PËR TË PUNËSUARIT NË KËSHILL**

KÇN, gjatë realizimit të objektivave të tij në pajtim me planin e punës dhe legjislacionin në fuqi ka hartuar, finalizuar dhe rekomanduar për miratim në Këshill edhe dy(2) Katalog të Pozitave dhe Përshkrimit të Vendeve të Punës për të Punësuarit në Këshill.

Katalogët e rekomanduar janë miratuar në Këshill dhe janë si në vijim:

1. Katalogu i Pozitave dhe Përshkrimit të Vendeve të Punës për të Punësuarit e Njesisë për Inspektim Gjyqësor;
2. Katalogu i Pozitave dhe Përshkrimit të Vendeve të Punës për të Punësuarit e Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Për shkak të dinamikave dhe prioriteteve të dala në Këshill gjatë periudhës raportuese, komisioni për arsyet e me poshtme nuk i ka propozuar këto akte:

- Rregullorja për Vlerësimin e Performancës së Kryesuesit, Zëvendës Kryesuesit dhe Anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës - edhe pse akti është shqyrtuar në KÇN dhe ka përfunduar fazën e konsultimit publik, për shkak të nismës për reformën në drejtësi ka mbetur si draft i pa finalizuar, me qëllim që të përshtatet me ndryshimet ligjore që parashihen të bëhen;
- Plotësimi dhe ndryshimi i Rregullores për përdorimin e SMIL – është shqyrtuar në KÇN, mirëpo në ndërkohë kanë dalë kërkesa dhe iniciativa nga kryetarët e gjykatave

dhe administratoret, prandaj KÇN draftin e rregullores e ka kthyer tek grupi punues me qëllim inkorporimit të kërkesave, ashtu që KÇN të mund të bëjë finalizimin e këtij drafti konform Udhëzuesit për Hartimin dhe Konsultimin Publik të Akteve Normative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, sipas të cilit duhet të sigurohet një draft i konsoliduar nga grupi punues i caktuar për hartimin e kësaj rregullore. Në kohën kur po raportojmë drafti është konsoliduar për konsultim publik.

- Rregullorja për Njësinë Ligjore të Gjykatës Komerciale – për shkaqe ligjore gjatë periudhës raportuese, propozimin e këtij drafti nga administratori dhe kreu i Njësisë Ligjore të Gjykatës Komerciale, komisioni nuk ka pasur kushte për shqyrtimin e kësaj draft rregullore. Mirëpo në kohën kur po raportojmë rregullorja është miratuar.
- Rregullorja për Organizimin dhe Funksonimin e Panelit për Lirim me Kusht - komisioni ende nuk ka pranuar draftin e konsoliduar nga grupi punues për shqyrtim.
- Rregullorja për rregullimin e skemës së kompensimit të anëtarëve të Këshillit dhe të disa kategorive të punësuarve të tjerë në sistemin gjyqësor – për këtë akt, anëtarët e Këshillit janë pajtuar të ndryshojnë emërtimin, duke e zëvendësuar me emërtimin Udhëzimi Administrativ Nr. X/2023 për Shpërblimin, Shtesat dhe Kompensimet për të Punësuarit dhe të Zgjedhurit në Sistemin Gjyqësor. Udhëzimi administrativ është finalizuar dhe është dërguar tek të gjithë anëtarët e Këshillit, drejtori i përgjithshëm i Sekretariatit, drejtori i Njësisë, drejtoret e Departamenteve dhe Zyrave në Sekretariat dhe Njësi, si dhe udhëheqësve të divizioneve në Sekretariat, në mënyrë që të japin komentet dhe sugjerimet e tyre lidhur me këtë draft.

Komisioni ka pranuar komente, të cilat janë shqyrtuar në takim joformal të anëtarëve të Këshillit, gjatë të cilit anëtarët janë pajtuar që drafti të tërhiqet nga pikat e rendit të ditës së takimit të Këshillit dhe të kthehet grupit punues për rishqyrtim me qëllim të harmonizimit me qëndrimin e marrë nga anëtarët e Këshillit. Në kohën kur po raportojmë drafti është në finalizim e sipër.

## **PËRFUNDIM**

Komisioni për Çështje Normative, në pajtim me Planin e punës së Këshillit për vitin 2022 dhe objektivat strategjike të mbështetura në Strategjinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka hartuar dhe miratuar planin e punës së tij. KÇN në plan të punës ka paraparë gjithsejtë njëzet e katër (24) akte normative për hartim, shqyrtim, finalizimin dhe rekomandim për miratim në Këshill.

Nga një njëzet e katër (24) akte normative të parapara në plan të punës, prej tyre katërbëdhjetë (14) akte normative kanë qenë të parapara për periudhën janar - qershor 2023, ndërkaq gjatë kësaj periudhe KÇN ka finalizuar dhe ka rekomanduar për miratim në Këshill katërbëdhjetë (14) akte normative, prej të cilave njëmbëdhjetë (11) akte janë sipas planit të punës, ndërsa tre (3) prej tyre janë akte normative të finalizuara jashtë planit të punës. Aktet jashtë planit të punës të finalizuara dhe rekomanduara për miratim në Këshill janë si në vijim:

- një (1) rregullore;
- një (1) rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores bazë; dhe,
- një (1) udhëzim administrative.

Gjatë kësaj periudhe katër (4) akte normative kanë mbetur jashtë realizimit të objektivit për periudhën janar- qershor 2023 për shkak se KÇN nuk ka pranuar drafte për këto akte ashtu siç parashihet me Udhëzuesin për Hartimin dhe Konsultimin Publik të Akteve Normative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, veçanërisht në nenin 9 dhe nenin 13 paragrafi 2.

Më tej, KÇN me qëllim të përmirësimit të nivelit të transparencës dhe duke konsideruar të rëndësishëm kontributin e shoqërisë civile dhe gjithë profesionistëve të interesuar ka proceduar në konsultim publik në afat prej 15 ditëve, ashtu siç parashihet me legjislacionin në fuqi.

Të gjitha aktet të cilat kanë përfunduar periudhën e konsultimit publik janë shqyrtuar, finalizuar dhe rekomanduar për miratim në Këshill, përjashtimisht draft Udhëzimit Administrativ Nr. X/2023 për Instalimin dhe Përdorimin e Kamerave të Sigurimit dhe Ruajtjen e Video Regjistrimeve në Gjykatat e Republikës Së Kosovës i cili ka përfunduar periudhën e konsultimit publik, janë shqyrtuar komentet, është finalizuar dhe se shpejti pritet të



rekomandohet për miratim ne Këshill. Ndërsa në kohën kur po raportojmë kjo rregullore është miratuar.

Në emër të KÇN, falënderojmë kryesuesin e Këshillit, anëtarët e komisionit, anëtarët e Këshillit, secilin gjyqtar pjesëmarrës në grupe punuese, drejtorët, sekretaren e komisionit, të gjithë zyrtarët e tjerë të Sekretariatit të Këshillit dhe Njesisë për Inspektim Gjyqësor si dhe praktikantët e financuara nga projekti i USAID për Drejtësi Komerçiale, partnerët ndërkombëtar si: BE, KE, USAID dhe OSBE, për kontributin, mbështetjen profesionale dhe mbështetjen me punëtori gjatë hartimit të akteve normative, si dhe shoqërinë civile, mediat dhe çdo grupi tjetër te interesit për komentet, rekomandimet dhe sugjerimet e tyre.

Prishtinë, 18 shtator 2023.

Drita Rexhaj,

Kryetare e KÇN-së,